

ASC-09-0004

Në padinë e

██████████, Shtime
Përfaqësuar nga ██████████, avokat nga Prishtina

*Paditësi/
1. Ankuesi*

Kundër

1. **NSH** ██████████, Shtime *Të Paditurit*
2. **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)**,
përfaqësuar nga UNMIK-u
3. **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**,
Nr. 8, Rruga Ilir Konushevci, Prishtinë *2. Ankuesi*
4. **Administrata Tatimore e Kosovës**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimi (DHPGJS) Kolegji i Ankesave i përbërë nga Torsten Frank Koschinka, si Gjyqtar Kryesues, Tapio Vanamo dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit dhe të Paditurit të tretë, kundër aktvendimit të DHPGJS-së më 26 shkurt 2009, SCC-08-0005, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 08 dhjetor 2010, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. **Ankesa e paditësit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 26 shkurt 2009, SCC-08-0005, refuzohet si e pabazuar.**

- 2. Propozimi plotësues për "kthimin e parave, dhe obligimin e të Paditurit që të paguajë kompensimin për dëmin dhe humbjen e fitimit" refuzohet si i papranueshëm.**
- 3. Ankesa e të Paditurit të tretë refuzohet si e papranueshme.**
- 4. Aktgjykimi i DHPGJS-së i datës 9 qershor 2009, SCC-08-0005, vërtetohet.**
- 5. Me rastin e ankesës, Pika 5 e aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 09 qershor 2009, SCC-08-0005, hiqet.**
- 6. Paditësi është i obliguar që t'i paguajë Dhomës së Posaçme tarifat gjyqësore në shumë prej 505.50 Euro.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Paditësi me anë të padisë së tij të parashtruar më 10 janar 2008 ka kërkuar anulimin e kontratës mbi shitjen e ngastrës kadastrale 302 në Petroviq në të cilën i Padituri i parë është palë. Për më tepër ai kërkoj që të vërtetohet si pronar i kësaj ngastrë dhe t'i lejohet atij të regjistrohet si i tillë në shënimet kadastrale. Paditësi pretendoi se ka blerë ngastrën kadastrale 302/2 në sipërfaqe prej 80 ari në mënyrë ligjore dhe se ka përmbushur të gjitha obligimet ligjore. Ai gjithashtu ka pretenduar se në të bazë të vërtetimit të shitjes, ATK-ja ka shitur pjesë të ngastrës kadastrale 302/2, në sipërfaqe prej 80 ari në shumë prej 85,100.00 (tetëdhjetë e pesë mijë e një qind) euro, prej të cilave 68,198.90 euro (gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë euro e nëntëdhjetë cent) është paguar në llogarinë e AKM-së Nr. 1000500559002298 dhe 16,392.10 euro (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e dhjetë cent) është paguar në llogarinë e ATK-së. Ai pretendoi se e drejta e tij për pronësi është bazuar në vendimin për shitje publike të ngastrës së tokës nga ana e ATK-së dhe në përmbushjen e obligimeve të tij. Për më tepër, ai pretendoi se ai e kishte fituar pronën mbi bazat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore 6/80, Gazeta

Zyrtare, RSFJ, Neni 20. Ai dëshmoi se kishte parashtruar një kërkesë për të regjistruar parcelën e tokës bazuar në vendimin e sipërpërmendur të ATK-së në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Shtimes dhe ka paguar taksat e nevojshme administrative, porse është ndaluar nga regjistrimi i të drejtave të tij.

Trupi Gjyqësor i DHPGJS-së me aktvendime të datave të ndryshme shtoi të Paditurit e dytë, tretë dhe katërt në padi. Arsyetimi për këtë ishte dhënë vetëm në lidhje me ATK-në, duke pretenduar se përfshirja e saj në padi është e nevojshme për një gjykim të plotë të padisë.

Paditësi më tej kërkoi nga DHPGJS-së që të lëshojë një ndalim të përkohshëm më 20 nëntor 2008 për të ndaluar të Paditurit (NSH-në dhe AKM-në) nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi për të shitur apo ndryshuar titullarin e pronësisë së ngastrës kadastrale në diskutim.

Me anë të aktvendimit të vetë të datës 26 shkurt 2009, Trupi Gjyqësor i DHPGJS-së lëshoi ndalimin e përkohshëm të kërkuar.

Gjatë procedurës gjyqësore të shkallës së parë u bë e qartë se ATK-ja nuk e ka konfiskuar ngastrën kadastrale që është diskutim i padisë nga i Padituri i parë, por një ngastër tjetër kadastrale, që është ngastra kadastrale 37/4 me fletë poseduese 42 në Shtime. Kjo ngastër gjithashtu është ajo që ishte shpallur të jetë çështje e ankandit publik, të mbajtur më 6 mars 2007, në të cilin Paditësi ishte shpallur si ofertuesi fitues. Nuk ishte e mundur që të sqarohet më tej se përse ATK-ja më 25 prill 2007 i ka lëshuar Paditësit një vërtetim të shitjes, duke deklaruar se ai kishte blerë ngastrën kadastrale 302 në Petroviq, e cila ishte parë edhe si pronë e të Paditurit të parë.

Më 09 qershor 2009 Trupi Gjyqësor i DHPGJS-së lëshoi një aktgjykim me anë të së cilit refuzoi padinë e Paditësit si të pabazuar dhe tërhoqi ndalimin e përkohshëm të lëshuar më 26 shkurt 2009.

Ai bazoi aktgjykimin e vetë në argumentin ligjor se, pasi që askush nuk mund të bartë më shumë të drejta tek tjetri se sa që posedon ai vetë, transferimi i pronësisë për ngastrën kadastrale të pa-konfiskuar nr. 302 në Petroviq nuk është transferuar siç duhet nga ATK-ja tek Paditësi.

Ankesa e të Paditurit 3. kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 26 shkurt 2009

Më 25 mars 2009, i Padituri i tretë ushtroi ankesë kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 26 shkurt 2009, me të cilën kërkoi tërheqjen e masës së përkohshme.

Ankesa e Paditësit kundër aktgjykimit të DHPGJS-së të datës 9 qershor 2009

Më 10 dhjetor 2009, Paditësi ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Trupit Gjykses të datës 9 qershor 2009 për vërtetim të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të të drejtës materiale. Paditësi kërkon që aktgjykimi të anulohet dhe çështja të referohet në shkallën e parë për rigjykim dhe për lëshimin e vendimit të ri; ose, ndryshe, të ndryshojë aktvendimin e kundërshtuar dhe të aprovojë padinë e Paditësit si të bazuar për ngastrën kadastrale 302 në Petroviq; ose, ndryshe, të obligojë të Paditurin që të kthejë paratë dhe të paguajë kompensimin për dëmet dhe fitimet e humbura, duke përfshirë të gjitha shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e kësaj ankese. Ai nuk ofron fakte të reja dhe nuk i kundërshton faktet e përmendura nga Trupi Gjykses, por thjeshtë e kundërshton aktvendimin e shkallës së parë duke pretenduar se gjendja nuk është vlerësuar siç duhet.

Arsyet ligjore:

1. Ankesa e të Paditurit të tretë:

Ankesa e të Paditurit të tretë kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 26 shkurt 2009 është e papranueshme dhe kështu duhej të refuzohej.

Pasi që në ndërkohë masa e përkohshme e atakuar ishte tërhequr nga Trupi Gjykses me aktvendimin e tij të datës 9 qershor 2009, nuk ka mbetur cenim ligjor i të drejtës për të Paditurin e tretë, e cila mund të ishte baza për ankesën e tij. Mungesa e cenimit të të drejtës e bën ankesën të papranueshme.

Me rastin e ankesës, Kolegji i Ankesave do të donte të sqaronte çështjen në vijim: Është e paqartë për Kolegjin e Ankesave, pse janë ftuar në gjykim i Padituri i dytë, tretë dhe i katërt dhe janë shtuar *ex officio* si të Paditur. Si e tillë, duhet të theksohet se "përfshirja" e thjeshtë e një pale tjetër si i Paditur, pa e zgjeruar Paditësi(t) padinë drejt të Paditurve tjerë, në përgjithësi është pa ndonjë lidhje përkatëse, dhe pa ndonjë ndikim në "palën" e ftuar në gjykim (krahaso ASC-09-0029, ASC-09-0035, ASC-10-0022 et al.). Ky është një nga parimet themelore të procedurës civile (të paktën në kontekst të Evropës kontinentale) që i mbetet ekskluzivisht Paditësit se kundër kujt dëshiron të nisë procedurën, e jo Gjykatës. Përveç marrjes parasysh të këtij parimi, masa e përkohshme e lëshuar dhe e tërhequr nga Trupi Gjykses edhe në kuptim të legjitimitetit pasiv i është adresuar të Paditurve të gabuar, pasi që vetëm pronari (pronari i pretenduar) i një ngastre mund të iniciojë ndryshime në statusin e tij të pronësisë. I Padituri i dytë dhe i tretë mund të kishin vepruar vetëm si përfaqësues të të Paditurit të parë, që do të thotë se do të ishte tërësisht e mjaftueshme të lëshohej masa e përkohshme me përmbajtjen e dhënë vetëm kundër të Paditurit të parë. Kërkesa për të lëshuar një masë të tillë kundër të Paditurit të dytë dhe të tretë do të duhej të ishte refuzuar si e pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të Paditurve të përmendur.

Pasi që palët "e ftuara në gjykim" nga Trupi Gjykses megjithatë, ashtu siç janë obliguar nga masa e përkohshme e lëshuar, janë palë aktuale të paktën në Procedurën e Ankesave, për këtë qëllim ata mbesin në pozitën e palëve para Kolegjit të Ankesave.

2. Ankesa e Paditësit:

Ankesa e Paditësit për sa i përket propozimit kryesor është e pranueshme, por e pabazuar (a). Për sa i përket propozimit plotësues ankesa është e papranueshme (b). Aktgjykimi i DHPGJS-së i datës 9 qershor 2019, SCC-08-0005 duhet të vërtetohet.

a. Paditësi nuk mund të kërkojë të drejtën e pronësisë mbi ngastrën 302 në Petroviq. ATK-ja, në përfundim, kishte të drejtë të anulonte kontratën e shitjes me Paditësin pasi që vet ATK-ja nuk ishte në pozitë ligjore që t'ia shiste ngastrën Paditësit. Sipas nenit 28-30 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/17, ATK-së i lejohet që të shesë pasuri që është konfiskuar nga debitori i taksave në mënyrë që të mbledhë paratë që debitori i detyrohet ATK-së. Siç e vuri në pah drejtë Trupi Gjykes, zbatimi jo vetëm i vetë ligjit por edhe zbatimi i tij duke marrë parasysh rregullën e përgjithshme se askush nuk mundet të bartë një të drejtë që ai vet nuk e ka (*nemo plus iuris ad alienum transferre quam ipse habet*) – me lirim të qartë, por në lëndën në fjalë jo të dhënë, të shitjeve *bona fide*, që në rastet e bartjes së pasurisë së patundshme nevojitet një supozim *bona fide* në formën e shitësit që është i regjistruar si pronar/posedues – ATK-ja me forcën detyruese nuk mundte të bartte pronësinë e ngastrës kadastrale në shqyrtim, pasi që jo vetëm se nuk e kishte konfiskuar atë më parë, por as nuk e kishte vënë në ankand. Në këtë mënyrë, kontrata e shitjes e anuluar nga ATK-ja ishte e pavlefshme *ex principio*.

ATK-ja konfiskoi ngastrën kadastrale 37 dhe 318/1 në fletën poseduese 42 në Shtime me sipërfaqe prej 9.53.62 Ha në mënyrë që të sigurojë detyrimin tatimor të NSH-së në shumë prej 16,392 Euro, në bazë të neneve 28 dhe 30 të Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Ankandi publik ishte mbajtur për shitjen ngastrës kadastrale 37. Megjithatë, gabimisht ATK-ja lëshoi një certifikatë të shitjes për Paditësin për ngastrën kadastrale 302 të NSH-së në Petroviq, e cila, siç u vu në dukje tashmë, asnjëherë nuk ishte konfiskuar nga ATK-ja e as nuk ishte shitur në ankand publik.

As Trupi Gjykes nuk duhej, e as Kolegji i Ankesave nuk do të vendosë në çështjen e vet-dukshme që del nga faktet e pakontestuar, nëse Paditësi ka blerë

gjatë ankandit publik ngastrën që ishte shpallur aty dhe nëse ai ka të drejtë të kërkojë të drejtën e tij të pronësisë – apo, më saktë, padinë e tij kundër ATK-së për t'ia bartë atij të drejtën e pronësisë – mbi ngastrën 37/4 në fletën poseduese 42 në Shtime.

b. Për sa kërkon Paditësi, ndryshe, "kthimin e parave, dhe të obligojë të Paditurin që të paguajë kompensimin për dëmin dhe humbje e fitimit", kjo duhet të kuptohet si propozim plotësues në rast se propozimi i tij kryesor do të mohohet. Si e tillë, është e papranueshme sipas neneve 61.4 dhe 60.4 të UA UNMIK-ut 2008/6.

Kolegji i Ankesave e interpreton kërkesën e Paditësit – që ka një formulim shumë të paqartë - për "kthimin e parave dhe për ta obliguar të Paditurin të paguajë kompensim për dëmin dhe humbjen e profitit" si një propozim për ta obliguar të Paditurin e parë dhe të katërt ta kthejnë pagesën e çmimit të shitblerjes dhe të paguajnë dëmin shtesë – nuk është precizuar lloji dhe shuma. Ndryshimi i padisë nga padia për vërtetim pronësie në një veprim të rregullt të pagesës (të një mënyre shumë të pasaktë) do të thotë të ndryshohet çështja ligjore e procedurës gjyqësore. Sipas nenit 60.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6, pasi që paditësi nuk ka kërkuar t'i kthehet çmimi i shitblerjes ose t'i aprovohen dëmet përmes një procedure gjyqësore para Trupit Gjyqësor, ai nuk mund të dëgjohet me padinë e tij të "re" në kuadër të procedurës gjyqësore para Kolegjit të Ankesave. Prandaj, ky propozim plotësues është dashur të trajtohej si një ankesë e papranueshme.

3. Udhëzime për parashtrim të ankesë (pika 5 e dispozitivit të aktvendimit të kontestuar):

Pika 5 e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar duhet të hiqet ex officio, pasi që udhëzimet për parashtrim të ankesës duke cituar ligjin pa ndonjë liri veprimi të gjykatës, nuk janë aktvendime që mund të përfshihen në dispozitiv. Një arsyetim i tillë mund të jepet në arsyetimin ligjor ose – më mirë –vetëm ti bashkëngjitet aktvendimit, por nuk mund të jetë pjesë e tij (ASC-09-0108 et al.).

4. Shpenzimet

Në analogji me nenin 12, paragrafi 1 i Ligjit mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 3 tetor 1987), Agjencia Kosovare e Privatizimit lirohet nga taksat gjyqësore (ASC-09-0020 et al.).

Sipas Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjykues duhet të vendosë mbi caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën e parë dhe Kolegji për Ankesa – kur lënda të vendoset përfundimisht- mbi caktimin e shpenzimeve procedurale në të dyja shkallët.

Në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një Rregullore Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat gjyqësore, sipas së cilës taksat gjyqësore në të dyja shkallët përmbajnë ne një rën anë tarifa për parashtrimin e parashtrësës(ave), dhe në anën tjetër, tarifa për lëshimin e aktvendimit(eve).

Sa i përket procedurës së ankimit: vlera e tarifës për parashtrim të ankesës siç rregullohet me Nenin 10.11 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ" është 30 (tridhjetë) euro.

Neni 10.12 i ADJ-së përcakton se për aktvendimet e bazuar në vlerën e objektit, tarifa duhet te paguhet sipas numrit të tarifës 10.1 të ADJ-së. Kjo zbatohet edhe për aktvendimet në shkallën e dyte, gjithashtu (Neni 10.23 ADJ i referohet neneve 10.12 deri në 10.18 të ADJ-së). Prandaj, neni 10.12, lidhur me Nenin 10.23 i mbulon aktvendimet në shkallën e dytë në bazë të vlerës së objektit.

Sipas nenit 10.1 lidhur me nenet 10.12 dhe 10.23, taksa gjyqësore për aktvendim mbi vlerën e objektit mbi 10,001 euro, taksa gjyqësore është 50 + 0.5% deri në maksimum prej 500 euro.

Në rastin konkret, vlera e ankesës është 85,100 euro. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendim në shkallën e dytë është 475.50 euro.

Në përgjithësi, aplikohen taksat vijuese gjyqësore për procedurën gjyqësore:

Tarifa e Taksës Gjyqësore, Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa e Taksës Gjyqësore Neni 10.12 lidhur me 10.23 dhe 10.1 (aktvendim në shkallën e dytë)	475.50 euro
Gjithsej	505.50 euro

Këto taksa gjyqësore i ngarkohen Paditësit.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së në lëndën ASC-09-0004 më 8 dhjetor 2010:

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar Kryesues
EULEX

Tapio Vanamo, Gjyqtar
EULEX

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruer
EULEX